



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 132

Tiranë – E mërkurë, 15 korrik 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 82/2020 datë 2.7.2020	Për ratifikimin e ndryshimit të Protokollit II të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9733, datë 14.5.2007, në lidhje me përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe “metoda e bashkëpunimit administrativ”.....
	7879
Dekret i Presidentit nr. 11538, datë 9.7.2020	Për shpallje ligji.....
	7881
Ligj nr. 83/2020 datë 2.7.2020	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e ndryshuar të Organizatës Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore (EUTELSAT).....
	7881
Dekret i Presidentit nr. 11539, datë 9.7.2020	Për shpallje ligji.....
	7892
Ligj nr. 84/2020 datë 2.7.2020	Për pranimin e vendimit II/1 të palëve, që ndryshon “Konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.....
	7892
Dekret i Presidentit nr. 11540, datë 9.7.2020	Për shpallje ligji.....
	7894
Dekret i Presidentit nr. 11542, datë 10.7.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....
	7894
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 2.7.2020	Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020.....
	7895

Urdhër i ministrit të Kulturës
nr. 223, datë 3.7.2020

Për miratimin e rregullores “Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar
të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë
Teknike dhe Sportelit Unik të saj”

7897

Kërkesë për shpalljen të zhdukur shtetasit Zenel Mustafaraj.....

7906



LIGJ
Nr. 82/2020

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË
PROTOKOLLIT II TË MARRËVESHJES
SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË TURQISË, TË
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9733,
DATË 14.5.2007, NË LIDHJE ME
PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT
“PRODUKTE ORIGJINUESE” DHE
“METODA E BASHKËPUNIMIT
ADMINISTRATIV”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i Protokollit II të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9733, datë 14.5.2007, në lidhje me përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe “metoda e bashkëpunimit administrativ”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11538, datë 9.7.2020
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

**VENDIM NR. 1/2019 I KOMITETIT
TË PËRBASHKËT**

**të themeluar nga Marrëveshja e Tregtisë së
Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe
Republikës së Turqisë, që zëvendëson
Protokollin II të Marrëveshjes së Tregtisë së
Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe
Republikës së Turqisë, në lidhje me
përcaktimin e konceptit të “produkteve
origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit
administrativ**

Duke pasur parasysh Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si “kjo Marrëveshje”) të nënshkruar në Tiranë më 22 dhjetor 2006, në veçanti nenin 22;

në pajtim me nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje që autorizon Komitetin e Përbashkët për marrjen e vendimeve;

duke marrë parasysh nenin 34 të Marrëveshjes në lidhje me ndryshimet;

në pajtim me nenin 35 të kësaj Marrëveshjeje që autorizon Komitetin e Përbashkët për të bërë ndryshime në këtë Marrëveshje;

duke pasur parasysh Protokollin II të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ (në vijim i referuar si “Protokolli II”);

duke pasur parasysh se:

1. Neni 22 i kësaj Marrëveshjeje i referohet Protokollit II, i cili zëvendësohet me vendimin nr. 1/2009 të Komitetit të Përbashkët të datës 30 korrik 2009¹, përcakton përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ dhe parashikon kumulimin e origjinës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Turqisë, BE-së dhe çdo vendi ose territori që merr pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian².

¹ “Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë” nr. 7, 20.3.2012 dhe Fletorja Zyrtare e Republikës së Turqisë nr. 27947, 28.5.2011.

² Siç përcaktohet në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme në prill 1997 dhe Komunikatën e Komisionit të muajit maj 1999, mbi krijimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.



2. Konventa Rajonale për rregullat preferenciale mbareuromesdhetare të origjinës³ (në vijim e referuar si “Konventa”) përcakton dispozitat për origjinën e mallrave të tregtuara, sipas marrëveshjeve përkatëse të lidhura ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe synon zëvendësimin e protokolleve për rregullat e origjinës që aktualisht janë në fuqi ndërmjet tyre me një akt të vetëm ligjor.

3. Konventa ka përfshirë pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizim-Asociimit në zonën mbareuromesdhetare të kumulimit të origjinës.

4. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë nënshkruan Konventën përkatësisht në datat 27 qershor 2011 dhe 4 nëntor 2011.

5. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë depozituan instrumentet e tyre të pranimit pranë depozitarit të Konventës përkatësisht në datat 5 mars 2012 dhe 4 dhjetor 2013. Si rrjedhojë, në zbatim të nenit 10 (3) të Konventës, Konventa hyri në fuqi në lidhje me Republikën e Shqipërisë më 1 maj 2012 dhe në lidhje me Republikën e Turqisë më 1 shkurt 2014.

6. Kur kalimi drejt Konventës nuk është i njëkohshëm për të gjitha Palët Kontraktuese brenda zonës së kumulimit, ai nuk duhet të sjellë ndonjë situatë më pak të favorshme se sa më parë, sipas Protokollit II.

7. Si rrjedhojë, Protokollit II duhet të zëvendësohet me një protokoll të ri, duke iu referuar Konventës,

Komiteti i Përbashkët,
ka vendosur si më poshtë:

Neni 1

Rregullat e origjinës

Në lidhje me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe të metodave të bashkëpunimit administrativ, Protokollit II i kësaj Marrëveshjeje dhe shtojcat e tij zëvendësohen me tekstin e paraqitur në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me nenin 34 të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e nënshkruar, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë vendim.

Bërë në ..., 2019, në dy kopje autentike në gjuhën angleze.

Në emër të Republikës së Shqipërisë

Në emër të Republikës së Turqisë

SHTOJCË

PROTOKOLL II NË LIDHJE ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE ORIGJINUESE” DHE METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Rregullat e zbatueshme të origjinës

1. Për qëllimin e implementimit të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen shtojca I dhe, sipas rastit, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës Rajonale, mbi rregullat preferenciale mbareuromesdhetare të origjinës⁴ (Konventa).

2. Të gjitha referencat ndaj “marrëveshjes përkatëse” në shtojcën I dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës interpretohen në kuptim të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse lindin mosmarrëveshje në lidhje me procedurat e verifikimit të nenit 32 të shtojcës I të Konventës, të cilat nuk mund të zgjidhen ndërmjet autoriteteve doganore që kërkojnë verifikimin dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, do t'i paraqiten Komitetit të Përbashkët të parashikuar në nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues, kryhet sipas legjislacionit të atij vendi.

³ Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L. 54, 26.2.2013, f. 4.
Faqe | 7880

⁴ Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L. 54, 26.2.2013, f. 4.



Neni 3

Amendimet e Protokollit

Komiteti i Përbashkët, i parashikuar në nenin 28 të Marrëveshjes, mund të vendosë për të amenduar dispozitat e këtij Protokollit.

Neni 4

Tërheqja nga Konventa

1. Nëse Republika e Shqipërisë ose Republika e Turqisë njoftojnë me shkrim depozitarin e Konventës, në lidhje me synimin e tyre për t'u tërhequr nga Konventa, sipas nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë do të fillojnë menjëherë bisedimet për rregullat e origjinës për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Deri në hyrjen në fuqi të rregullave të origjinës të saponenegociuara, rregullat e origjinës të përfshira në shtojcën I dhe sipas rastit, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës, të zbatueshme në momentin e tërheqjes, do të vazhdojnë të zbatohen për këtë Marrëveshje. Megjithatë, që nga momenti i tërheqjes, rregullat e origjinës të përfshira në shtojcën I dhe sipas rastit, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës do të interpretohen në mënyrë që të lejojnë kumulimin dypalësh vetëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.

Neni 5

Dispozitat e përkohshme – kumulimi

1. Pavarësisht nenit 3 të shtojcës I të Konventës, rregullat mbi kumulimin e parashikuar në nenet 3 dhe 4 të Protokollit II të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshuar me vendimin nr. 1/2009 të Komitetit të Përbashkët të datës 30 korrik 2009⁵, do të vazhdojnë të zbatohen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë derisa Konventa të ketë hyrë në zbatim në lidhje me të gjitha Palët e listuara në nenet 3 dhe 4 të Protokollit II të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pavarësisht neneve 16 (5) dhe 21 (3) të shtojcës I të Konventës, ku kumulimi i origjinës

përfshin vetëm Bashkimin Evropian, shtetet e EFTA-s, Ishujt Faroe, Turqia dhe pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizim-Asociimit të BE-së, prova e origjinës mund të jetë një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose një deklaratë origjine.

DEKRET

Nr. 11538, datë 9.7.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 82/2020 “Për ratifikimin e ndryshimit të Protokollit II, të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9733, datë 14.5.2007, në lidhje me përkufizimin e konceptit ‘Produkte origjinuese’ dhe ‘Metoda e bashkëpunimit administrativ’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**LIGJ
Nr. 83/2020**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E
NDRYSHUAR TË ORGANIZATËS
EVROPIANE TË
TELEKOMUNIKACIONEVE
SATELITORE (EUTELSAT)**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e ndryshuar të Organizatës Evropiane të Tele-

⁵ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr. 7, datë 20.3.2012, dhe Fletorja Zyrtare e Republikës së Turqisë nr. 27947, datë 28.5.2011.



komunikacioneve Satelitore (EUTELSAT), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11539, datë 9.7.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

ORGANIZATA EVROPIANE E TELEKOMUNIKACIONEVE SATELITORE

KONVENTA E NDRYSHUAR

SHËNIM REDAKSIONAL

Amendimet e Konventës origjinale, që krijojnë këtë Konventë të ndryshuar, janë miraturar nga Asambleja e Palëve të EUTELSAT-it në maj të vitit 1999. Ato janë zbatuar mbi një bazë të përsheptuar (të përkohshme) që nga data 2 korrik 2001, në përputhje me një rezolutë për këtë qëllim, miraturar nga Asambleja e Palëve të EUTELSAT-it edhe në maj 1999.

Hyrë në fuqi, në mënyrë përfundimtare, më 28 nëntor 2002.

TABELA E LËNDËS

Hyrja

Neni I	Përkufizimet
Neni II	Krijimi i EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A.
Neni III	Qëllimet e EUTELSAT-it
Neni IV	Personaliteti juridik
Neni V	Kostot
Neni VI	Struktura e EUTELSAT-it
Neni VII	Asambleja e Palëve – Përbërja dhe mbledhjet
Neni VIII	Asambleja e Palëve – Procedura
Neni IX	Asambleja e Palëve – Funksionet
Neni X	Sekretariat
Neni XI	Të drejtat dhe detyrimet
Neni XII	Selia e EUTELSAT-it, privilegjet, imunitetet, përjashtimet
Neni XIII	Tërheqja
Neni XIV	Ndryshimet dhe përfundimi
Neni XV	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni XVI	Nënshkrimi – Rezervat

Neni XVII	Hyrja në fuqi
Neni XVIII	Aderimi
Neni XIX	Përgjegjësia
Neni XX	Dispozitat e ndryshme
Neni XXI	Depozituesi
Aneksi A	Dispozitat kalimtare
Aneksi B	Procedura e arbitrazhit

HYRJE

Shtetet Palë në këtë Konventë,

duke theksuar rëndësinë e telekomunikacionit, me anë të satelitit për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet popujve dhe ekonomive të tyre, dhe dëshirën e tyre për të forcuar bashkëpunimin në këtë fushë;

duke vërejtur se Organizata e përkohshme për Telekomunikacionin Satelitor Evropian “INTERIM EUTELSAT” është krijuar me qëllim për të operuar në segmentin hapësinor të sistemeve evropiane të telekomunikacionit satelitor;

duke marrë në konsideratë dispozitat përkatëse të Traktatit mbi Parimet që rregullojnë aktivitetet e shteteve në eksplorimin dhe shfrytëzimin e hapësirës kozmike, përfshirë Hënë dhe trupat e tjerë qiellorë, përfunduar në Londër, Moskë dhe Uashington, më 27 janar 1967;

duke dëshiruar vazhdimin e krijimit dhe operimit të sistemit të telekomunikacionit satelitor EUTELSAT, si pjesë e një rrjeti transevropian të telekomunikacionit, për të siguruar shërbime telekomunikacioni për të gjitha shtetet pjesëmarrëse, pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë në marrëveshjet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare;

duke dëshiruar vazhdimin e krijimit dhe të operimit të sistemit satelitor të telekomunikacioneve EUTELSAT, si pjesë e rrjetit të telekomunikacioneve transevropiane për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve për të gjitha shtetet pjesëmarrëse, pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë në marrëveshjet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare;

duke njohur nevojën për të mbajtur nën shqyrtim dhe, sipas nevojës, për t’iu përshtatur zhvillimeve teknike, ekonomike, rregullatore dhe politike në Evropë dhe në botë, dhe, në veçanti, vullnetin për të transferuar veprimtaritë operative dhe asetet shoqëruese të EUTELSAT-it në një kompani me



përgjegjësi të kufizuara, të themeluar nën një juridiksion kombëtar, kompani të tilla për të vepruar mbi baza të qëndrueshme financiare dhe ekonomike, duke pasur në vëmendje parimet e pranuar tregtare dhe Marrëveshjen,

bien dakord si më poshtë:

Neni I Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “Konventë” do të thotë Konventa për krijimin e Organizatës Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore “EUTELSAT”, përfshirë hyrjen dhe anekset e saj, e hapur për nënshkrim nga qeveritë në Paris, më 15 korrik 1982, e amenduar më pas;

b) “Marrëveshje e përkohshme” do të thotë marrëveshja mbi themelimin e një organizate të përkohshme evropiane të telekomunikacionit satelitor “INTERIM EUTELSAT”, përfunduar në Paris, më 13 maj 1977, ndërmjet administratave apo agjencive të njohura operuese private dhe e depozituar pranë administratës franceze;

c) “ECS marrëveshja” nënkupton marrëveshjen plotësuese të marrëveshjes së përkohshme në lidhje me segmentin hapësinor të Sistemit të Telekomunikacionit Satelitor për Shërbimin Fiks (ECS), përfunduar në Paris, më 10 mars 1978;

d) “Palë” nënkupton një shtet, për të cilën Konventa ka hyrë në fuqi ose ka qenë përkohësisht e zbatueshme;

d) “Drejtor i përgjithshëm i EUTELSAT-it” do të thotë kreu i organit ekzekutiv të EUTELSAT-it;

f) “Sekretari Ekzekutiv i EUTELSAT-it” do të thotë kreu i Sekretariatit të EUTELSAT;

g) “Kompania Eutelsat S.A.” nënkupton një ndërmarrje, korporatë, e themeluar sipas ligjeve të njëjës prej Palëve; ajo fillimisht do të jetë e vendosur në Francë;

h) “Segment hapësinor” nënkupton një grup satelitësh të telekomunikacionit dhe ndjekja, telemeteringu, komandimi, kontrolli, monitorimi, shërbimet e lidhura dhe pajisjet për mbështetjen operative të këtyre satelitëve;

i) “Sistemi satelitor” nënkupton njësinë e formuar nga një segment hapësinor dhe stacionet tokësore, duke pasur akses në këtë segment hapësirë;

j) “Telekomunikacion” nënkupton çdo transmetim, emetim ose marrje të shenjave, sinjaleve, shkrimeve, imazheve dhe tingujve ose inteligjencja e çfarëdo natyre, nga sistemet kabllore, radio, optike ose sisteme të tjera elektromagnetike;

k) “Parimet Themelore” nënkupton parimet e përmendura në nenin III, germa “a” e Konventës;

l) “Marrëveshje” do të thotë marrëveshja ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A., duke pasur si qëllim të saj, përcaktimin e marrëdhënies ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. dhe detyrimet e tyre përkatëse, në veçanti për të siguruar kuadrin që do të mundësojë EUTELSAT-in të mbikëqyrë dhe të sigurojë respektimin nga Kompania Eutelsat S.A. të Parimeve Themelore.

Neni II Krijimi i EUTELSAT-it dhe i Kompanisë Eutelsat S.A.

a) Nëpërmjet kësaj Konvente, Palët formojnë Organizatën Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore, e quajtur më poshtë “EUTELSAT”.

b) i. Kompania Eutelsat S.A. do të krijohet për të operuar një sistem satelitor dhe për të ofruar shërbime satelitore dhe, për këtë qëllim, asetet e EUTELSAT-it dhe aktivitetet operacionale do t'i transferohen Kompanisë Eutelsat S.A.

ii. Kompania Eutelsat S.A. do të funksionojë nëpërmjet instrumenteve kushtetuese të saj dhe nga ligjet e vendit ku do të jetë regjistruar.

iii. Çdo Palë, në territorin e të cilit janë vendosur selitë e kompanisë Eutelsat S.A. ose në të cilin janë vendosur dhe/ose operojnë asetet, në përputhje me marrëveshjet e bëra ndërmjet Palëve dhe Kompanisë Eutelsat S.A., duhet të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar krijimin dhe funksionimin e kompanisë Eutelsat S.A.

c) Marrëdhëniet ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. do të përcaktohen në këtë marrëveshje.

d) Dispozitat përkatëse të aneksit A të Konventës do të zbatohen për qëllime të vazhdimësisë midis aktiviteteve të EUTELSAT-it dhe atyre të Kompanisë Eutelsat S.A.



Neni III

Qëllimet e EUTELSAT

a) Qëllimi kryesor i EUTELSAT-it është të garantojë që Parimet Themelore të përcaktuara në këtë nen të respektohen nga Kompania Eutelsat S.A. dhe, konkretisht:

i. Detyrimet për shërbimin publik/shërbimin universal: detyrime të tilla zbatohen për segmentin e hapësirës dhe për përdorimin e saj për të ofruar shërbime për rrjetin publik telefonik të komutuar; shërbimet audiovizuale dhe shërbimet e së ardhmes do të sigurohen në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti, dispozitat e Konventës Evropiane për Televizionin Ndërkufitar, duke marrë parasysh ato që zbatohen në konceptin e shërbimit universal dhe shoqërinë e informacionit;

ii. Mbulimi panevropian nga sistemi satelitor: Kompania Eutelsat S.A. duhet, mbi baza ekonomike, të kërkojë që nëpërmjet mbulimit panevropian të sistemit të saj satelitor t'u shërbejë të gjitha zonave ku është e nevojshme, për shërbimet e komunikimit në shtetet anëtare;

iii. Mosdiskriminimi: shërbimet do të ofrohen për përdoruesit në mënyrë të barabartë, duke pranuar fleksibilitet/tolerancë tregtare dhe në përputhje me ligjet e zbatueshme;

iv. Konkurrencë e ndershme: Kompania Eutelsat S.A. duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme që lidhen me konkurrencën e ndershme.

b) EUTELSAT-i, gjithashtu, duhet të ketë qëllim të sigurojë vazhdimësinë, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, sipas ligjit ndërkombëtar, në veçanti sipas radorregulloreve për përdorimin e frekuencave që rrjedhin nga përdorimi i segmentit hapësiror të EUTELSAT-it, që i janë transferuar Kompanisë Eutelsat S.A.

Neni IV

Personaliteti juridik

a) EUTELSAT-i ka personalitet juridik.

b) EUTELSAT-i do të gëzojë zotësi të plotë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj dhe për arritjen e qëllimeve të saj dhe, në veçanti mund të:

i. të lidhë kontrata;

ii. të blejë, të marrë/japë me qira, të zotërojë dhe të disponojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;

iii. të marrë pjesë si Palë në gjykim;

iv. të lidhë marrëveshje me shtetet ose organizatat ndërkombëtare.

Neni V

Kostot

a) Marrëveshjet do të lidhen ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. për të mbuluar kostot dhe shpenzimet e EUTELSAT-it, sipas Marrëveshjes.

b) Kostot e shkaktuara për themelimin dhe funksionimin e Sekretariatit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në marrjen me qira dhe kostot e lidhura me të, mbajtjen e zyrave, pagat dhe shpërblimet e stafit, kostot e organizimit dhe të zhvillimit të mbledhjeve të Asamblesë së Palëve, kostot e konsultimit ndërmjet EUTELSAT dhe Palëve, dhe organizimeve të tjera, si dhe kostot për zbatimin e masave të marra nga EUTELSAT, sipas nenit III, për të garantuar që Parimet Themelore janë respektuar nga Kompania Eutelsat S.A., do të përballohen nga Kompania Eutelsat S.A., në përputhje me paragrafin “a”, të nenit V, brenda kufijve përkatës të përcaktuar në Marrëveshje.

Neni VI

Struktura e EUTELSAT-it

a) EUTELSAT-i do të ketë organet e mëposhtme:

i. Asambleja e Palëve;

ii. Sekretariati, i kryesuar nga Sekretari Ekzekutiv.

b) Çdo organ do të veprojë brenda kufijve të kompetencave që janë akorduar nga Konventa.

Neni VII

Asambleja e Palëve – Përbërja dhe mbledhjet

a) Asambleja e Palëve do të jetë e përbërë nga të gjitha Palët.

b) Një Palë mund të përfaqësohet nga një Palë tjetër në një mbledhje të Asamblesë së Palëve, por asnjë palë nuk mund të përfaqësojë më shumë se dy palë të tjera.



c) Mbledhja e parë e zakonshme e Asamblesë së Palëve do të zhvillohet brenda një viti pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi. Mbledhjet e zakonshme pas kësaj do të mbahen çdo dy vjet, përveç rasteve kur Asambleja e Palëve vendos në një mbledhje të zakonshme se mbledhja pasuese do të mbahet në një interval të ndryshëm.

d) Asambleja e Palëve, gjithashtu, mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesë të një apo më shumë Palëve, mbështetur nga të paktën një e treta e Palëve ose me kërkesë të Kompanisë Eutelsat S.A. Një kërkesë e tillë do të përcaktojë qëllimin e takimit.

d) Çdo Palë do të mbulojë shpenzimet e veta të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Palëve.

Neni VIII

Asambleja e Palëve – Procedura

a) Çdo Palë do të ketë një votë në Asamblenë e Palëve. Palët që abstenojnë nga votimi do të konsiderohet si mosvotuese.

b) Vendimet mbi çështjet thelbësore, duhet të merren me votë konfirmuese nga të paktën dy të tretat e palëve të pranishme ose atyre që përfaqësojnë dhe votojnë. Një Palë e cila përfaqëson një ose dy Palë të tjera, siç parashikohet në paragrafin “b”, të nenit VII të Konventës mund të votojë veçmas për secilën Palë të cilën përfaqëson.

c) Vendimet për çështje procedurale do të merren nga një votë konfirmuese nga një shumicë e thjeshtë e Palëve të pranishme dhe që votojnë, secila ka një votë.

d) Kuorumi për çdo mbledhje të Asamblesë së Palëve do të përbëhet nga përfaqësuesit e një shumice të thjeshtë të të gjitha Palëve, nëse jo më pak se një e treta e të gjitha Palëve janë të pranishme.

e) Asambleja e Palëve do të miratojë rregullat e veta të procedurës, të cilat do të jenë në përputhje me dispozitat e Konventës dhe, në veçanti, do të përfshijnë dispozita, për:

i. zgjedhjen e kryetarit të tij dhe të zyrtarëve të tjerë;

ii. mbajtjen e mbledhjeve;

iii. përfaqësimin dhe akreditimin;

iv. procedurat e votimit.

Neni IX

Asambleja e Palëve – Funksionet

Asambleja e Palëve do të ketë funksionet e mëposhtme:

a) të ketë në konsideratë dhe të kontrollojë aktivitetet e Kompanisë Eutelsat S.A., që lidhen me Parimet Themelore. Kompania Eutelsat S.A. mund të bëjë rekomandime në lidhje me këtë, të cilat do të shqyrtohen nga ana e Asamblesë së Palëve;

b) të sigurojë respektimin nga Kompania Eutelsat S.A., të Parimeve Themelore, në përputhje me rregulloren;

c) të marrë vendime mbi ndryshimet e propozuara në rregullore, këto ndryshime të jenë subjekt i marrëveshjes së përbashkët të Palëve në rregullore;

d) të marrë vendimet e duhura, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë, për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve sipas ligjit ndërkombëtar, në veçanti bazuar në radorregulloret për përdorimin e frekuencave, që rrjedhin nga përdorimi i segmentit hapësinor EUTELSAT, transferuar Kompanisë Eutelsat S.A.;

e) të marrë vendime mbi marrëdhëniet formale midis EUTELSAT-it dhe shteteve, qofshin Palë ose jo apo organizatat ndërkombëtare dhe, në veçanti, për të negociuar marrëveshjen për selinë qendrore, siç parashikohet në paragrafin “c”, të nenit XII të Konventës;

f) të marrë vendime për çdo propozim për përfundimin e Konventës, në zbatim të paragrafit “c”, të nenit XIV;

g) të marrë në konsideratë ankesat e parashtruara për të, nga Palët;

h) të marrë vendime bazuar në nenin XIII të Konventës, në lidhje me tërheqjen e një Pale nga EUTELSAT-i;

i) të vendosë mbi çdo propozim për amendimin e Konventës, bazuar në nenin XIV të Konventës dhe të paraqesë te Kompania Eutelsat S.A. çdo amendim të propozuar që ndikon në përmbushjen e aktiviteteve të saj;

j) të vendosë mbi çfarëdo kërkesë, për anëtarësim, të bërë në përputhje me paragrafin “e”, të nenit XVIII, të Konventës;

k) siç kërkohet, në bazë të nenit X të kësaj Konvente, për të vendosur mbi emërimin dhe largimin nga detyra të Sekretarit Ekzekutiv, dhe mbi rekomandimin e Sekretarit Ekzekutiv, të



përcaktojë numrin, statusin, termat dhe kushtet e punësimit për të gjithë stafin e Sekretariatit, duke marrë në konsideratë Marrëveshjen;

l) të caktojë një zyrtar të lartë të Sekretariatit për të shërbyer si Sekretar Ekzekutiv në detyrë, kurdoherë që Sekretari Ekzekutiv mungon, është i paaftë të kryejë detyrat e postit të Sekretarit Ekzekutiv ose nëse ky post bëhet vakant;

m) të miratojë një buxhet vjetor ose dyvjeçar;

n) të miratojë ndryshimet për vendndodhjen e Kompanisë Eutelsat S.A., në përputhje me marrëveshjen.

Neni X Sekretariati

a) Sekretariati do të drejtohet nga Sekretari Ekzekutiv i emëruar nga Asambleja e Palëve.

b) Mandati i Sekretarit Ekzekutiv do të jetë katër vjet, përveç rastit kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Palëve.

c) Asambleja e Palëve mund ta largojë Sekretarin Ekzekutiv me arsye, para përfundimit të mandatit të tij.

d) Sekretari Ekzekutiv do të jetë përfaqësuesi ligjor i EUTELSAT-it. Sekretari Ekzekutiv do të veprojë nën drejtimin e Asamblesë së Palëve dhe do të jetë drejtpërdrejt përgjegjës para tij, për përmbushjen e të gjitha funksioneve të Sekretariatit.

e) Sekretari Ekzekutiv do të ketë fuqinë të emërojë të gjithë stafin e Sekretariatit në bazë të miratimit të Asamblesë bazuar në nenin IX/“k”.

f) Gjatë çdo vendi të lirë në postin e Sekretarit Ekzekutiv ose, kur Sekretari Ekzekutiv mungon ose është i paaftë të kryejë detyrat e tij, Sekretari Ekzekutiv në detyrë, i caktuar sipas rregullave nga Asambleja e Palëve, do të ketë fuqinë për të ushtruar kompetencat e Sekretarit Ekzekutiv bazuar në Konventë.

g) Sekretari Ekzekutiv dhe stafi i Sekretariatit do të shmangin çdo veprim të papajtueshëm me përgjegjësitë e tyre në EUTELSAT.

Neni XI Të drejtat dhe detyrimet

a) Palët do të ushtrojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrimet e tyre sipas Konventës, në përputhje të plotë me dhe në vijim të parimeve dhe dispozitave të Konventës.

b) Të gjitha Palët mund të marrin pjesë në të gjitha konferencat dhe mbledhjet në të cilat ata kanë të drejte të përfaqësohen, sipas parashikimeve në Konventë dhe në çdo mbledhje tjetër të thirrur ose të mbajtura nën kujdesin e EUTELSAT-it, në përputhje me marrëveshjen e bërë nga ai për takime të tilla, pavarësisht nga vendi se ku ata mund të zhvillohen.

c) Përpara se një konferencë ose mbledhje e tillë të zhvillohet jashtë vendit në të cilin është vendosur selia e EUTELSAT-it, Sekretari Ekzekutiv do të garantojë që marrëveshjet me Palën pritëse të këtyre takimeve dhe konferencave përfshijnë një dispozitë që rregullon hyrjen dhe qëndrimin në vendin organizues gjatë konferencës apo takimit nga përfaqësuesit e të gjitha Palëve që kanë të drejtë të marrin pjesë.

Neni XII Selia EUTELSAT, privilegjet, imunitetet, përjashtimet

a) Selia e EUTELSAT do të jetë në Francë.

b) Brenda fushës së aktivitetit të autorizuar nga Konventa, EUTELSAT dhe prona e saj, në territorin e të gjitha Palëve, do të përjashtohet nga tatimet e drejtpërdrejta mbi pasuritë dhe të ardhurat dhe nga detyrimet doganore.

c) Çdo Palë do të njohë, në përputhje me Protokollin e përmendur në këtë paragraf, privilegjet e duhura, përjashtimet dhe imunitetet EUTELSAT, zyrtarëve të tij, dhe për atë kategori të punonjësve të saj të specifikuar në Protokoll, të Palët dhe përfaqësuesit e Palëve, dhe të personave që marrin pjesë në procedurën e arbitrazhit. Në veçanti, secila Palë duhet t'u njohë këtyre individëve imunitet nga ndjekja ligjore, në lidhje me veprimet e kryera ose fjalët e shkruara apo të shqiptuara në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe brenda kufijve të detyrave të tyre, në masën dhe në raste të parashikuara në Protokollin e përmendur në këtë paragraf. Pala, në territorin e së cilës është e vendosur Selia e EUTELSAT-it, duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, të hartojë ose, sipas rastit, të rihartojë me EUTELSAT-in, një protokoll që përfshin privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet. Palët e tjera gjithashtu, sa më shpejt që të jetë e mundur, të hartojnë një Protokoll, që përfshin privilegje, përjashtimet dhe imunitetet. Marrëveshja për selinë qendrore dhe Protokollin do të



përshkruajë për secilin kushtet e përfundimit të tij dhe do të jetë i pavarur nga Konventa.

Neni XIII Tërheqja

a) Çdo Palë mund të tërhiqet vullnetarisht nga EUTELSAT-i në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim te depozitari, siç përcaktohet në nenin XXI. Një tërheqje e tillë do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari.

b) Nëse një Palë ka dështuar të pajtohet me ndonjë detyrim sipas Konventës, Asambleja e Palëve, pasi ka marrë njoftim për këtë rezultat ose duke vepruar me iniciativën e saj dhe duke konsideruar çdo përfaqësim të bërë nga Palët, mund të vendosë, nëse konstaton se dështimi për t'u pajtuar ka ndodhur, që Pala të konsiderohet se është tërhequr nga EUTELSAT-i dhe, nga data e një vendimi të tillë, Konventa do të pushojë së qenëri në fuqi për atë Palë. Një mbledhje e jashtëzakonshme e Asamblesë së Palëve mund të thirret për këtë qëllim.

c) Një Palë e cila është tërhequr ose mendohet të jetë tërhequr nga EUTELSAT-i do pushojë të ketë të drejtën e përfaqësimit në Asamblenë e Palëve dhe nuk do të ketë asnjë pasojë ose detyrim apo përgjegjësi pas datës efektive të tërheqjes, përveç detyrimeve që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet para asaj date.

d) Çdo njoftim i tërheqjes dhe çdo vendim që ndikon në tërheqjen e konsideruar do t'u komunikohet menjëherë të gjitha Palëve nga depozitari.

Neni XIV Ndryshimet dhe ndërprerja

a) Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë dhe duhet t'i komunikohen Sekretarit Ekzekutiv, i cili menjëherë do t'i qarkullojë propozimet te të gjitha Palët. Asambleja e Palëve do të shqyrtojë amendamentin e propozuar jo më parë se gjashtë muaj nga qarkullimi i saj, duke marrë parasysh çdo rekomandim të bërë nga Kompania Eutelsat S.A., pikëpamjet e së cilës duhet të kërkojnë në qoftë se propozimi për amendim i Konventës, është i detyruar të ndikojë në performancën e aktiviteteve të saj. Kjo periudhë mund, në ndonjë rast të

veçantë, të reduktohet nga Asambleja e Palëve, me një vendim të marrë në përputhje me procedurën për një çështje thelbësore.

b) Nëse miratohet nga Asambleja e Palëve, amendimet do të hyjnë në fuqi njëqind e njëzet ditë, pasi Depozituesi ka marrë njoftimet e pranimit nga dy të tretat e këtyre shteteve, të cilat, në kohën e miratimit nga Asambleja e Palëve, ishin Palë. Me hyrjen e saj në fuqi, amendimet do të bëhen të detyrueshme për të gjitha Palët.

c) Palët mund të çojnë EUTELSAT-in në fundin e tij, me përfundimin e Konventës me dy të tretat e shumicës së të gjitha Palëve.

d) Përfundimi i kësaj Konvente nuk do të ndikojë në vazhdimin e ekzistencës së Kompanisë Eutelsat S.A.

d) Nëse nuk është rënë dakord ndryshe me Kompaninë Eutelsat S.A., asnjë vendim për përfundimin e EUTELSAT-it, bazuar në paragrafin “c” të këtij neni, nuk do të merret për atë kohë, sa të drejtat ndërkombëtare dhe detyrimet e përmendura në paragrafin “b”, të nenit III nuk janë shuar tërësisht.

Neni XV Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet Palëve ose ndërmjet EUTELSAT dhe një pale, ose disa Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës, do t'i dorëzohen arbitrit, në përputhje me shtojcën B të Konventës, në qoftë se, nuk zgjidhet ndryshe brenda një viti nga koha që njëra Palë në mosmarrëveshje ka njoftuar Palën tjetër për qëllimin e saj, për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje, miqësisht nëpërmjet arbitrazhit.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës ndërmjet një Pale dhe një shteti që ka pushuar së qenëri Palë ose ndërmjet EUTELSAT dhe një shteti, i cili ka pushuar së qenëri Palë, dhe këto mosmarrëveshje kanë lindur pasi shteti ka pushuar së qenëri Palë, do të dorëzohen në arbitrazh, në përputhje me dispozitat e shtojcës B të Konventës, nëse nuk zgjidhet ndryshe brenda një viti që njëra Palë në mosmarrëveshje ka njoftuar Palën tjetër për qëllimin e saj, për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore, me kusht që shteti i cili ka pushuar së qenëri Palë në këtë mënyrë bie dakord. Nëse një shtet pushon së qenëri Palë, nëse janë



pjesë e një mosmarrëveshjeje e cila është paraqitur në arbitrazh, sipas paragrafit “a” të këtij neni, arbitrazhi do të vazhdojë dhe do të mbyllet.

Neni XVI

Nënshkrimi – Rezervimet

a) Çdo shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose Agjencia e Njohur Operuese Private në këtë fushë është ose ka të drejtë për t’u bërë një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme, mund të bëhet Palë në Konventë nëpërmjet:

i. nënshkrimit që nuk u nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit; ose

ii. nënshkrimit që u nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

iii. aderimit.

b) Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim në Paris nga 15 korriku 1982 deri në hyrjen në fuqi dhe pas kësaj mbetet e hapur për aderim.

c) Asnjë rezervë nuk mund t’i bëhet kësaj Konvente.

Neni XVII

Hyrja në fuqi

a) Konventa do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës në të cilën ajo është firmosur, në përputhje me nënparagrafin “i”, të paragrafit “a”, të nenit XVI të Konventës ose, kur është ratifikuar, pranuar ose miratuar, nga dy të tretat e shteteve, të cilat, në datën në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim, kanë juridiksion mbi Palët nënshkruese të Marrëveshjes së Përkohshme, me kusht që këto Palë nënshkruese ose nënshkruesit e caktuar të tyre të Marrëveshjes ECS, të mbajnë të paktën dy të tretat e aksioneve financiare nën Marrëveshjen ECS.

b) Konventa nuk do të hyjë në fuqi në më pak se tetë muaj pas datës në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim. Konventa nuk do të hyjë në fuqi në qoftë se ajo nuk ka qenë e nënshkruar, ratifikuar, pranuar ose miratuar, sipas paragrafit “a” të këtij neni, brenda tridhjetë e gjashtë muajsh nga data në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim.

c) Për një shtet, instrumenti i ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit të të cilit është depozituar pas datës në të cilën Konventa hyn në

fuqi, Konventa do të të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të tillë.

d) Me hyrjen në fuqi, Konventa do të zbatohet përkohësisht për çdo shtet i cili e ka kushtëzuar nënshkrimin me ratifikimin, pranimin ose miratimin dhe ka kërkuar këtë gjë, në kohën e nënshkrimit ose në çdo kohë të mëvonshme para hyrjes në fuqi. Zbatimi i përkohshëm do të përfundojë:

i. me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit nga ana e atij shteti; ose

ii. në fund të dy viteve nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi pa u ratifikuar, pranuar ose miratuar nga shteti; ose

iii. pas njoftimit nga ana e atij shteti, para përfundimit të periudhës së përmendur në nënparagrafin “ii” të këtij paragrafi, për vendimin e saj për të mos ratifikuar, pranuar ose miratuar Konventën.

Kur aplikimi i përkohshëm përfundon sipas nënparagrafit “ii” ose “iii” të këtij paragrafi, paragrafi “c”, të nenit XIII të Konventës do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e Palës.

e) Me hyrjen në fuqi, Konventa do të zëvendësojë dhe do të përfundojë Marrëveshjen e Përkohshme. Megjithatë, asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë ndonjë të drejtë apo detyrim të Palës së fituar në kapacitetin e saj të mëparshëm si një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme.

Neni XVIII

Aderimi

a) Çdo shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose agjencia e njohur operuese private ka qenë ose kishte të drejtën të bëhej, një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme, në datën në të cilën Konventa është e hapur për nënshkrim, mund të aderojë në Konventë nga data në të cilën ajo pushon së qenëri e hapur për nënshkrim, deri në dy vjet pas hyrjes së saj në fuqi.

b) Dispozitat e paragrafëve “c”, “e” të këtij neni do të zbatohen për kërkesat për anëtarësim nga shtetet e mëposhtme:

i. një shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose Agjencia e njohur operuese private e fushës ishte ose kishte të drejtën për t’u bërë, një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme, në datën në të cilën Konventa u hap për



nënshkrim, i cili nuk është bërë Palë e Konventës në përputhje me nënparagrafët “i” ose “ii”, të paragrafit “a”, të nenit XVI të Konventës, ose paragrafin “a” të këtij neni;

ii. çdo shtet tjetër evropian i cili është anëtar i Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit që dëshiron të aderojë në Konventë pas hyrjes së saj në fuqi.

c) Çdo shtet që dëshiron të aderojë në Konventë në rrethanat e përmendura në paragrafin “a” të këtij neni (shteti kërkues) do të njoftojë Sekretarin Ekzekutiv me shkrim dhe do t’i paraqesë Sekretariatit të gjitha informacionin përkatës për kërkesën.

d) Sekretari Ekzekutiv do të marrë aplikimin e shtetit kërkues dhe ia paraqet atë Asamblesë së Palëve.

e) Asambleja e Palëve do të marrë një vendim për kërkesën e shtetit kërkues brenda gjashtë muajve pas datës në të cilën Sekretari Ekzekutiv vendos që ai ose ajo ka plotësuar të gjithë informacionin e kërkuar sipas paragrafit “c” të këtij neni. Vendimi i Sekretarit Ekzekutiv do t’i njoftohet menjëherë Asamblesë së Palëve. Vendimi i Asamblesë së Palëve do të merret me votim të fshehtë dhe në përputhje me procedurat për vendimet mbi çështjet thelbësore. Asambleja e Palëve mund të mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme për këtë qëllim.

f) Sekretari Ekzekutiv do të njoftojë shtetin kërkues për kushtet për aderim të vendosura nga Asambleja e Palëve, të cilat do të jetë pjesë e një protokolli që i bashkëngjitet instrumentit të pranimi të depozituar nga ky shtet pranë depozitarit.

Neni XIX Përgjegjësia

Asnjë Palë nuk do të jetë individualisht përgjegjëse për veprimet dhe detyrimet e EUTELSAT-it, me përjashtim kur të tilla përgjegjësi, rezultojnë nga një traktat, në të cilën Pala dhe një shtet që kërkon kompensim janë Palë. Në këtë rast, EUTELSAT-i do të dëmshpërblejë Palën e interesuar, duke respektuar çdo detyrim, me përjashtim, kur ky i fundit ka marrë përsipër shprehimisht që do të jetë përgjegjës në mënyrë ekskluzive.

Neni XX

Dispozita të ndryshme

a) Gjuhët zyrtare dhe të punës së EUTELSAT-it do të jenë anglishtja dhe frëngjishtja.

b) EUTELSAT-i duhet, që duke pasur parasysh pikëpamjet e përgjithshme të Asamblesë së Palëve, të bashkëpunojnë mbi çështjet e interesit të përbashkët me Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të saj, në veçanti Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

c) Në përputhje me Rezolutën 1721 (XVI) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, EUTELSAT-i do t’i dërgojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dhe agjencive të specializuara të interesuara, për informacionin e tyre, një raport vjetor mbi aktivitetet e saj. Raporti vjetor duhet, gjithashtu, t’i dërgohet Kompanisë Eutelsat S.A.

Neni XXI

Depozitari

a) Qeveria e Republikës Franceze do të jetë depozitari i kësaj Konvente, me të cilën do të depozitohen instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, kërkesat për aplikim të përkohshëm dhe njoftimet e ratifikimit, pranimi ose miratimit të amendimeve dhe të vendimit të tërheqjes nga EUTELSAT-i, ose përfundimit të zbatimit të përkohshëm të Konventës.

b) Konventa do të depozitohet në arkivat e depozitarit. Depozitari do të dërgojë kopje të njësuar/certifikuar të tekstit të Konventës për të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar atë apo që kanë depozituar instrumentet e aderimit në të dhe te Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.

c) Depozitari duhet menjëherë të informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar apo aderuar në Konventë dhe, nëse është e nevojshme, Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, për:

i. të gjitha nënshkrimet e Konventës;

ii. depozitim të të gjitha instrumenteve të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit;

iii. fillimin e periudhës gjashtëdhjetëditore, referuar në paragrafin “a”, të nenit XVII të Konventës;

iv. hyrjen në fuqi të Konventës;



v. të gjitha kërkesat për aplikim të përkohshme sipas paragrafit “d”, të nenit XVII të Konventës;

vi. emërimin e Sekretarit Ekzekutiv, sipas paragrafit “a” të nenit X të Konventës;

vii. miratimin dhe hyrjen në fuqi e të gjitha amendimeve të Konventës;

viii. të gjitha njoftimet për tërheqje;

ix. të gjitha vendimet e Asamblesë së Palëve, sipas paragrafit “b”, të nenit XIII të Konventës që një Palë konsiderohet se është tërhequr nga EUTELSAT-i;

x. të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera rreth Konventës.

d) Me hyrjen në fuqi të Konventës, depozitari duhet t'i dërgojë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kopje të konfirmuar të njësuar të kësaj Konvente.

Dëshmuar nga nënshkruesit e autorizuar nga qeveritë respektive, kanë nënshkruar këtë Konventë 6(*).

E hapur për nënshkrim në Paris, në ditën e pesëmbëdhjetë të korrikut, njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një origjinale të vetme.

SHTOJCA A Dispozita kalimtare

1. Vazhdimësia e aktiviteteve

a) Çdo marrëveshje nënshkruar nga EUTELSAT-i, e cila është në fuqi në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar, do të mbetet në fuqi, nëse dhe derisa të modifikohet ose përfundojë, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Çdo vendim i marrë nga EUTELSAT-i i cili është në fuqi në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar do të mbetet në fuqi nëse dhe derisa ky vendim të modifikohet ose përfundojë.

b) Në qoftë se, në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar, çdo organ i EUTELSAT-it ka nisur, por nuk ka përfunduar,

çdo veprim, i cili është i autorizuar apo i nevojshëm për t'u marrë, Sekretari Ekzekutiv apo Drejtori Ekzekutiv (CEO) i parë i kompanisë Eutelsat S.A., brenda kompetencave të tyre përkatëse dhe në përputhje me marrëveshjet e bëra ndërmjet EUTELSAT-it dhe kompanisë Eutelsat S.A., do të zëvendësojë atë organ me qëllim përfundimin e një aktiviteti të tillë.

2. Mënyra e transferimit

a) EUTELSAT-i do të hyjë në një marrëveshje transferimi (Marrëveshja e Transferimit) me Kompaninë Eutelsat S.A., për të transferuar çdo aset ose të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me aktivitetin e saj (plotësisht, të përcaktuar nga Marrëveshja e Transferimit) të Kompania Eutelsat S.A. (Transferimi).

b) Transferimi do të rezultojë në një transferim universal të të gjitha të drejtave, titujt, interesat dhe përfitimet mbi to, gjithashtu, dhe të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësi bashkëngjitur, asetet dhe përgjegjësitë e transferuara do të përbëjë një filial të plotë dhe autonom të aktivitetit. Një transferim i tillë do të ketë të njëjtat efekte si një *spin-off* (ndarje) transferim aktiviteti, parashikuar në nenin 382 në vijim, të ligjit francez, N° 66–537, të 24 korrikut, 1966, në lidhje me shoqëritë tregtare, me përjashtim që asnjë nga detyrimet dhe formalitetet normalisht të detyrueshme mbi transferuesin (shoqërinë transferuese), sipas ligjit, do të jenë të zbatueshme për EUTELSAT-in.

c) Në veçanti dhe pa paragjykim për sa më sipër, transferimi do të ketë efekte *erga omnes* (ndaj të gjithëve) që nga data e përcaktuar në Marrëveshjen e Transferimit pa i kërkuar njoftim, pëlqim apo miratim, çdo personi, duke përfshirë çdo personi ndaj të cilit, çdo detyrim dhe përgjegjësi e tillë, i detyrohet. Transferimi do të ketë efekte në të njëjtën mënyrë, në lidhje me çdo person, me të cilin EUTELSAT-i, ka lidhur një marrëveshje të një natyre *intuitu personae*.

3. Menaxhimi

a) Bazuar në pikën 2/“c” më sipër, i gjithë personeli i organit ekzekutiv të EUTELSAT-it do të ketë drejtën për t'u transferuar në Kompaninë Eutelsat S.A., si dhe personat që e ushtrojnë këtë të drejtë në datën e transferimit të tyre do të gëzojnë termat dhe kushtet e punësimit që janë, për aq sa ato janë në përputhje me ligjin francez, të paktën të barasvlershme me ato që ata gëzonin menjëherë para datës së transferimit të tyre.

⁶ Shtetet anëtare të EUTELSAT-it: Austria, Belgjika, Qipro, Danimarka, Finlanda, Franca, [Gjermani (Fed. Rep)], Greqi, Islandë, Irlandë, Itali, Libtenshtajni, Luksemburgu, Malta, Monako, Hollanda, Norvegjia, Portugalia, San Marino, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Vatikani, Jugosllavia.



b) Në lidhje me personat të cilët, në datën e transferimit, janë në marrjen e përfitimeve sipas rregullave të Skemës së Pensioneve të EUTELSAT-it, këto përfitime do të vazhdojnë të paguhen, në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse, të këtyre rregullave, të cilat ishin në fuqi, si në datën e transferimit.

c) Në lidhje me personat të cilët, në datën e transferimit, kanë fituar të drejta për të marrë përfitimet, sipas rregullave të Skemës së Pensioneve të EUTELSAT-it, do të bëhen rregullimet e duhura në mënyrë që t'u ruhen këto të drejta.

d) Në përputhje me paragrafin 1 të kësaj shtojce, kushtet e punësimit të personelit në fuqi, do të vazhdojnë të zbatohen deri sa kushtet e reja të punësimit do të hartohen nga Kompania Eutelsat S.A.

e) Deri sa Kryetari i parë i Drejtorisë së Kompanisë Eutelsat S.A., dhe Sekretari i Parë Ekzekutiv të marrin zyrarisht detyrat, funksionet e tyre përkatëse do të kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it.

4. Transferimi të Kompania Eutelsat S.A. dhe të Sekretari Ekzekutiv i funksioneve të EUTELSAT-it.

a) Në datën e themelimit të Kompanisë Eutelsat S.A. dhe të Sekretariatit, Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it njofton të gjithë të interesuarit.

b) Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it do të marrë të gjitha masat për një transferim në kohë të Kompania Eutelsat S.A. dhe Sekretari Ekzekutiv, të të gjitha të drejtave dhe të detyrimeve të fituara nga EUTELSAT-i, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor i EUTELSAT-it.

SHTOJCA B

Procedura e arbitrazhit

1. Për qëllime të gjykimit të çdo mosmarrëveshjeje referuar nenit XV të Konventës, do të krijohet një Gjykatë Arbitrazhi në lidhje me paragrafët në vijim.

2. Çdo Palë e Konventës mund t'i bashkohet secilës Palë në arbitrazh.

3. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë. Secila Palë në mosmarrëveshje do të emërojë një arbitër brenda një periudhe prej dy muajsh, llogaritur nga data e marrjes së kërkesës nga njëra Palë për të përcjellë mosmarrëveshjen

në arbitrazh. Aty ku neni XV i Konventës kërkon marrëveshje të Palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjet në arbitrazh, periudha prej dy muajsh, do të llogaritet nga data e kësaj marrëveshjeje. Dy arbitrat e parë, brenda një periudhe prej dy muajsh, llogaritur nga caktimi i arbitrit të dytë, emërojnë arbitrin e tretë, i cili do të jetë Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit. Nëse një prej dy arbitruesve nuk ka qenë i caktuar brenda periudhës së kërkuar, me kërkesë të secilës Palë, ai do të emërohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose, nëse nuk ka marrëveshje ndërmjet Palëve, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit. E njëjta procedurë do të zbatohet në qoftë se kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit nuk ka qenë i nominuar brenda periudhës së kërkuar.

4. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë selinë e saj dhe do të vendosë rregullat e veta të procedurës.

5. Secila Palë do të mbartë koston, në lidhje me arbitrin, për nominimin e të cilit ai është përgjegjës, si dhe kostot e të qenurit i përfaqësuar para gjykatës. Shpenzimet në lidhje me kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen në mënyrë të barabartë nga Palët në mosmarrëveshje.

6. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit do të merret me shumicën e anëtarëve të tij, të cilët nuk mund të abstenojnë nga votimi. Ky vendim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjitha Palët në mosmarrëveshje dhe asnjë ankesë nuk do të ekzistojë kundër tij. Palët do të pajtohen me vendimin pa vonesë. Në rastin e një mosmarrëveshjeje sipas kuptimit të saj apo qëllimit, Gjykata e Arbitrazhit do ta interpretojë atë me kërkesë të çdo pale në mosmarrëveshje.



DEKRET

Nr. 11539, datë 9.7.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 83/2020 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e ndryshuar të Organizatës Europiane të Telekomunikacioneve Satelitore (EUTELSAT)”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 84/2020

**PËR PRANIMIN E VENDIMIT II/1 TË
PALËVE, QË NDRYSHON
“KONVENTËN E AARHUSIT PËR TË
DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË PASUR
INFORMACION, PËR TË MARRË PJESË
NË VENDIMARRJE DHE PËR T’IU
DREJTUAR GJYKATËS PËR ÇËSHTJET
E MJEDISIT”, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 8672, DATË 26.10.2000**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranohet vendimi II/1 i palëve, që ndryshon “Konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Faqe | 7892

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11540, datë 9.7.2020
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

KOMBET E
BASHKUARA
KËSHILLI EKONOMIK
DHE SOCIAL

Distr. E PËRGJITHSHME
ECE/MP.PP/2005/2/Add.2
20 Qershor 2005
ORIGINALI ENGLISH

KOMISIONI EKONOMIK PËR EVROPËN
Takim i Palëve të Konventës mbi Aksesin në Informacionin, Pjesëmarrjen Publike në Vendimarrje dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet Mjedisore

**RAPORT I TAKIMIT TË DYTË TË
PALËVE**

SHITESË

VENDIMI II/1
ORGANIZMA TË MODIFIKUAR
GJENETIKISHT

Miratuar në takimin e dytë të Palëve të mbajtur në Almaty, Kazakistan, më 25–27 maj 2005

Takimi i Palëve,
duke njohur rëndësinë e zgjerimit të mëtejshëm të zbatimit të Konventës të vendimet në lidhje me lejimin ose jo të nxjerrjes së vullnetshme të organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ-të), ndër të tjera, duke zbatuar dispozita më të posaçme se ato të parashikuara në nenin 6, paragrafi 11, i Konventës;

Duke kujtuar vendimin I/4;

duke njohur nevojat praktike të Palëve dhe Nënshkruesve të Konventës, posaçërisht ato me ekonomi në tranzicion, në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit të brendshëm për biosigurinë, duke përfshirë nevojat e tyre për dispozita më të forta për pjesëmarrjen publike,

GE.05-31950;

duke njohur nevojën për të bashkëpunuar me organizata dhe forume të tjera ndërkombëtare, posaçërisht Protokollin e Kartagenës për



Biosigurinë, me synim maksimizimin e sinergjisë dhe të shmangies së mbivendosjes së përpjekjeve, ndërmjet të tjerash, duke inkurajuar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Sekretariatit të Konventës dhe asaj të Protokollit të Kartagenës;

duke u bërë thirrje të gjitha Palëve dhe Nënshkruesve të Konventës të ratifikojnë ose të aderojnë, sipas rastit, në Protokollin e Kartagenës, pasi kjo është një mundësi për të zhvilluar një kuadër të brendshëm të biosigurisë, duke përfshirë vlerësimin e riskut dhe procedurat e vendimmarrjes që përfshijnë pjesëmarrjen e publikut dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen në programet e ndërtimit të kapaciteteve, posaçërisht në kontekstin e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara/Projekti i Strukturës Globale të Mjedisit;

duke besuar që, pavarësisht zhvillimeve në forume të tjera, Konventa e Aarhusit ofron një kuadër të përshtatshëm ndërkombëtar për zhvillimin e mëtejshëm të aksesit në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi në lidhje me OMGJ-të;

duke mbështetur përdorimin e vazhdueshëm të udhëzimeve për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi, në lidhje me Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (MP.PP/2003/3), që ai ka miratuar si instrument jodetyrues, vullnetar,

duke theksuar aktivitetet dhe raportet e Grupit të Punës për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht:

1. Miraton ndryshimin e Konventës që përcaktohet në aneksin e këtij vendimi;

2. Inkurajon Palët të ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë ndryshimin në mundësinë më të parë dhe ta zbatojnë atë në masën maksimale të mundshme deri në hyrjen e tij në fuqi;

3. Inkurajon, gjithashtu, Palët të përtërijnë përpjekjet e tyre për të zbatuar udhëzimet;

4. Vendos të rishikojë progresin në ratifikimin, pranimin dhe aprovimin e ndryshimit dhe zbatimin e udhëzimeve në takimin e tij të tretë.

ANEKS NDRYSHIM I KONVENTËS

Neni 1

Pika 11, e nenit 6, ndryshon si më poshtë vijon:

“11. Pa cenuar nenin 3, paragrafi 5, dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për vendimin për lejimin

ose jo të nxjerrjes së vullnetshme në mjedis dhe të futjes në treg të organizmave të modifikuar gjenetikisht.”.

Neni 2

Pas nenit 6, shtohet neni 6/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 6/1

Pjesëmarrja e publikut në vendimet për nxjerrjen e vullnetshme në mjedis dhe vendosjen në treg të organizmave të modifikuar gjenetikisht

1. Në pajtim me modalitetet e parashikuara në aneksin I bis, secila Palë siguron informacion të hershëm dhe efektiv dhe pjesëmarrje publike, para marrjes së vendimeve, nëse duket të lejohet nxjerrja e vullnetshme në mjedis dhe vendosja në treg e organizmave të modifikuar gjenetikisht.

2. Kërkesat e vendosura nga Palët në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni duhet të jenë plotësuese dhe reciprokisht mbështetëse të dispozitave të kuadrit të brendshëm për biosigurinë, në pajtim me objektivat e Protokollit të Kartagenës për Biodiversitetin.”.

Neni 3

Pas aneksit 1 shtohet aneksi 1/1 me këtë përmbajtje:

“PROCEDURA/DETYRIMET E REFERRUARA NË NENIN 6/1

1. Çdo Palë parashikon, në kuadrin e saj rregullator, masat për informimin efektiv dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimet që u nënshtrohen parashikimeve të nenit 6/1, brenda një afati kohor të arsyeshëm, me qëllim që t'i jepet publikut një mundësi e përshtatshme për të shprehur një mendim në lidhje me vendimet e propozuara.

2. Në kuadrin saj rregullator, Palët, sipas rastit, mund të parashikojnë përjashtime nga procedura e pjesëmarrjes së publikut, e parashikuar në këtë aneks:

a) Në rastin e nxjerrjes së vullnetshme të organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ) në mjedis, për çdo qëllim, përveç atij të futjes në treg, nëse:



i. një nxjerrje e tillë në kushte të krahaseshme biogeografike është aprovuar tashmë brenda kuadrit rregullator të Palës përkatëse; dhe

ii. është grumbulluar tashmë eksperiencë e mjaftueshme me nxjerrjen e OMGJ-ve në fjalë në ekosisteme të krahaseshme.

b) Në rastin e futjes së OMGJ-ve në treg, nëse:

i. është aprovuar brenda kuadrit rregullator të Palës përkatëse; ose

ii. synohet për kërkime ose për koleksione kulturore.

3. Pa cenuar legjislacionin e zbatueshëm për konfidencialitetin, në përputhje me parashikimet e nenit 4, çdo Palë i ofron publikut në një mënyrë të përshtatshme, efektive dhe në kohë, një përmbledhje të njoftimit të prezantuar për të marrë një autorizim për nxjerrjen e vullnetshme në mjedis ose futjen në treg të një OMGJ-je në territorin e saj, si dhe raportin e vlerësimit, sipas rastit, dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar mbi biosigurinë.

4. Palët, në asnjë rast nuk e konsiderojnë si konfidencial informacionin e mëposhtëm:

a) Një përshkrim të përgjithshëm të organizmit ose organizmave përkatës të modifikuar gjenetikisht, emrin dhe adresën e kërkuesit për autorizimin e nxjerrjes së vullnetshme, përdorimet e synuara dhe, sipas rastit, vendndodhjen e nxjerrjes;

b) Metodat dhe planet për monitorimin e organizmit ose organizmave përkatës të modifikuar gjenetikisht dhe për masat e emergjencës;

c) Vlerësimin e riskut mjedisor.

5. Çdo Palë garanton transparencën e procedurave vendimmarrëse dhe siguron informacionin procedural përkatës për publikun. Ky informacion mund të përfshijë:

i. natyrën e vendimeve të mundshme;

ii. autoritetin publik përgjegjës për marrjen e vendimit;

iii. masat për pjesëmarrjen e publikut të përcaktuara në përputhje me paragrafin 1;

iv. adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës;

v. adresimin tek autoriteti publik mund të paraqiten komentet, si edhe informimin për kohën e paraqitjes së tyre.

6. Parashikimet e bëra në përputhje me paragrafin 1 i lejojnë publikut të paraqesë çdo koment, informacion, analizë ose opinion që ai e

konsideron të arsyeshëm, në lidhje me propozimin për nxjerrjen e vullnetshme, duke përfshirë futjen në treg, në çdo mënyrë të përshtatshme.

7. Çdo Palë do të përpiqet të sigurojë që, kur merret një vendim, nëse duhet të lejohet nxjerrja e vullnetshme e OMGJ-ve në mjedis, duke përfshirë futjen e tyre në treg, do të merren në konsideratë rezultati i pjesëmarrjes së publikut në përputhje me paragrafin 1.

8. Palët do të sigurojnë që, kur merret një vendim, sipas parashikimeve të këtij aneksi nga autoriteti publik, teksti i vendimit së bashku me arsyetimin dhe konsideratat mbi të cilat është bazuar, bëhet i disponueshëm për publikun.”.

DEKRET

Nr. 11540, datë 9.7.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 84/2020, “Për pranimin e vendimit II/1, të palëve, që ndryshon ‘Konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit’, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS

SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11542, datë 10.7.2020

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre personave, të mëposhtëm:

1. Wendy Arjan Lleshi
2. Ermala Hysni Münster (Çela/Cela)
3. Emel Ilir Caka
4. Ariola Hiqmet Sandoval Wong (Tahirka)
5. Leandër Azis Veizi
6. Xhoana Fatmir Eckhardt (Maloku)
7. Gëzim Ismail Çullhaj
8. Ardit Esat Suli
9. Bora Artan Xhelili
10. Romeo Petrit Doksan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 19, datë 2.7.2020

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE
TË MATURËS SHTETËRORE 2020 DHE
TË MATURËS SHTETËRORE
PROFESIONALE 2020**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2020, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2020 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2020 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2020 |
| ç) Provimi me zgjedhje | 3 shtator 2020 |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2020 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2020 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2020 |
| ç) Teori profesionale e integruar | 3 shtator 2020 |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni dytë, bazohen në “Rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020, në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 537, datë 8.11.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe “Rregulloren e posaçme për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID-19”, miratuar me urdhrin nr. 114, datë 18.5.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Në rastin ku parashikimet e këtyre rregulloreve të sipërcituara kanë rregullim të ndryshëm me parashikimet e këtij udhëzimi, do të zbatohen parashikimet e këtij të fundit.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë:

- a) Fillojnë në orën 10:00.
- b) Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
- c) Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
- ç) Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje është i ndërtuar vetëm me pyetje me alternativa dhe vlerësohet me 60 pikë.

5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

- a) maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i parë;
- b) maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2019–2020 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 20 gusht 2020;
- c) kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2019, por që nuk kanë shlyer



detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020.

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, që kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA-ja dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020.

6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “d”, të këtij udhëzimi të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar/zyra vendore e arsimit parauniversitar (këtu e në vijim “DRAP/ZVAP”) në vendbanimet e tyre.

7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “d”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë formularin A1Z, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z, në datat 21–23 gusht 2020.

8. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë, deri në datën 21 gusht 2020. Drejtori i ZVAP-së, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 21 gusht 2020.

9. Provimet të zhvillohen të përqendruara në ZVAP. ZVAP-të, të përcaktojnë qendrat dhe mjediset ku maturantët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre, sipas kushteve dhe numrit të maturantëve/kandidatëve.

10. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë.

11. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, brenda datës 19 gusht 2020, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore

2020, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar njofton për këto qendra dhe mjedise Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.

13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2020 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2020, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Arsimit dhe Formimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit dhe Formimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

**URDHËR**

Nr. 223, datë 3.7.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË
KULTURORE MATERIALE, KËSHILLIT
TEKNIK, SEKRETARISË TEKNIKE DHE
SPORTELET UNIK TË SAJ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si edhe të vendimit nr. 208, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe të gjitha organet dhe institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për zbatimin e kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

RREGULLORE**PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË
KULTURORE MATERIALE, KËSHILLIT
TEKNIK, SEKRETARISË TEKNIKE DHE
SPORTELET UNIK TË SAJ**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”), sipas parashikimeve të ligjit 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (në vijim “ligji 27/2018”), si dhe të vendimit nr. 208, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është veprimtaria e KKTKM-së, Këshillit Teknik, Sportelit Unik dhe Sekretarisë Teknike.

2. Kjo rregullore përcakton:

- a) rregullat dhe procedurën e funksionimit të KKTKM-së;
- b) të drejtat dhe detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KKTKM-së;
- c) transparencën e punës së KKTKM-së;
- ç) instrumentet ligjore dhe teknike për zhvillimin e duhur të veprimtarisë administrative dhe teknike të KKTKM-së.

Neni 3
Parimet

Anëtarët e KKTKM-së, gjatë kryerjes së detyrave, udhëhiqen nga parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) barazisë së të drejtave të personave;
- c) pavarësisë;
- ç) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
- d) drejtësisë dhe paanësisë;
- dh) profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit të shërbimit;



- e) ruajtjes së konfidencialitetit;
- ë) papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

Neni 4

Vula e KKTKM-së

KKTKM-ja ka vulën e vetë zyrtare, e cila përmban këto të dhëna:

- a) Në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS”;
- b) Në rrethin e dytë shkruhet: “KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE” dhe “SEKRETARIA TEKNIKE”;
- c) Në qendër të vulës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Përbërja e KKTKM-së

KKTKM-ja përbëhet nga 15 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 14 anëtarë që emërohen prej tij.

Neni 6

Emërimi dhe mbarimi i mandatit të anëtarit të KKTKM-së

1. Anëtari i KKTKM-së emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 208, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale” (në vijim “VKM 208/2019”).

2. Anëtari i KKTKM-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin 15 ditë përpara largimit. Anëtari ka detyrimin të përmbushë detyrat e ngarkuara deri në largimin e tij, si dhe të dorëzojë detyrën sipas procedurës përkatëse.

3. Lirimi nga detyra i anëtarit të KKTKM-së bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Urdhri për lirimin përmban arsyen, kohën e mbarimit të detyrës dhe/ose detyrat apo përgjegjësitë e anëtarit në dorëzimin e detyrës.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarit të KKTKM-së

1. Kryetari i KKTKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta, si vijojnë:

- a) kryeson dhe drejton mbledhjet e KKTKM-së;
- b) emëron dhe liron nga detyra anëtarët e KKTKM-së;
- c) miraton rendin e ditës për çështjet që do të shqyrtojnë KKTKM-ja;
- ç) nënshkruan vendimet e KKTKM-së.

2. Sekretari i KKTKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta, si vijojnë:

- a) asiston kryetarin në mbledhjet e KKTKM-së;
- b) propozon anëtarët përfaqësues nga IKTK-ja;
- c) propozon rendin e ditës për çështjet që do të shqyrtojnë KKTKM-ja;
- ç) ka të drejtë vote për çështjet në shqyrtim;
- d) ushtron funksionet e tij me profesionalizëm dhe me përgjegjshmëri;
- dh) të shmangë dhe të njoftojë kryetarin për çdo situatë konflikti interesi që ka dijeni;
- e) siglon vendimet e KKTKM-së;
- ë) drejton Sekretarinë Teknike dhe Këshillin Teknik.

3. Anëtari i KKTKM-së ka të drejta dhe detyra të veçanta si vijojnë:

- a) të njihet me dosjen dhe çdo dokument tjetër që lidhet me çështjen për të cilën do të marrë vendim;
- b) të shprehë lirshëm mendimin e tij;
- c) të kërkojë caktimin e ekspertëve të jashtëm kur vlerëson se çështja ka nevojë për ekspertizë më të thelluar;
- ç) të shpërblehet si anëtar i KKTKM-së;
- d) të marrë pjesë rregullisht në mbledhje;
- dh) të ushtrorë funksionet e tij me profesionalizëm dhe me përgjegjshmëri;
- e) të ruajë konfidencialitetin për çështjet, dokumentet dhe faktet për të cilat ka marrë dijeni për shkak të detyrës;
- ë) të shmangë çdo situatë konflikti interesi;
- f) të votojë;
- g) të arsyetojë mendimin kundër.



Neni 8 Sporteli Unik

1. Sporteli Unik është pjesë përbërëse e strukturës administrative pranë IKTK-së dhe shërben si një pikë e vetme për depozitimin e kërkesave/aplikimeve për licencim, miratimin e lejeve, planeve, projekteve ose çdo çështjeje që u paraqitet për miratim organeve kolegjal, sipas parashikimeve të ligjit 27/2018. Personi përgjegjës/nëpunësi i Sportelit Unik emërohet me urdhër të posaçëm nga drejtori i përgjithshëm i IKTK-së.

2. Sporteli Unik ka detyrat si vijojnë:

- a) regjistron dhe mban regjistrin për kërkesat/aplikimet e paraqitura;
- b) hap dosjen për çdo kërkesë/aplikim të paraqitur;
- c) verifikon përmbushjen e kriterëve për dokumentacionin që duhet të shoqërojë kërkesën/aplikimin;
- ç) dorëzon dosjen te përgjegjësi i Sektorit të Sekretarisë Teknike.

3. Regjistri i kërkesave/aplikimeve mbahet në dy forma:

- a) në formë manuale; dhe/ose
- b) në formë elektronike.

4. Regjistri i hyrjes së kërkesave përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e kërkesës, i cili është edhe numri i dosjes;
- b) të dhënat e subjektit kërkues;
- c) datën e dorëzimit të kërkesës;
- ç) objektin e kërkesës dhe dokumentacionin e depozituar;
- d) datën e dërgimit në Sekretarinë Teknike;
- dh) datën e dërgimit në Këshillin Teknik;
- e) datën e dërgimit në KKTKM;
- ë) datën e njoftimit të vendimit kërkuesit.

Neni 9 Aplikimi në sportel

1. Kërkuesit aplikojnë pranë Sportelit Unik nëpërmjet plotësimit/depozitimit të gjitha të dhënave, sipas llojit të aplikimit, në përputhje me formularët e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në rastin kur aplikimi sipas këtij ligji bëhet me formularë dhe në rastet e tjera, sipas parashikimeve të ligjit. Kërkuesi

dorëzon dhe dokumentacionin shoqërues, sipas kërkesave të akteve ligjore ose nënligjore në varësi të llojit të aplikimit.

2. Nëpunësi i Sportelit Unik bën regjistrimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur, në regjistrin e hyrjeve dhe hap dosjen përkatëse të çështjes. Pas kryerjes së regjistrimit dhe njëkohësisht hapjes së dosjes, nëpunësi verifikon pagesën e tarifës përkatëse për shërbimin që kërkohet.

3. Nëse kërkesa e paraqitur nuk përmban të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj ose në aktet nënligjore, nëpunësi i sportelit njofton kërkuesin dhe i cakton atij një afat 10-ditor për plotësimin e të metave të kërkesës. Nëse kërkuesi nuk i plotëson të metat brenda afatit të caktuar, e kthen dosjen “pa veprim”.

4. Nëse dokumentacioni është i plotë apo plotësohet brenda afatit të përcaktuar 10-ditor, nëpunësi i sportelit, ia kalon brenda ditës dosjen përkatëse Sekretarisë Teknike për procedim të mëtejshëm.

5. Për çdo veprim të kryer nëpunësi i sportelit raporton para drejtorit të përgjithshëm të IKTK-së.

Neni 10 Sekretaria Teknike

1. Sekretaria Teknike është një strukturë administrative e krijuar pranë IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat/aplikimet e ardhura nga Sporteli Unik, përgatit mbledhjet e KKTKM-së, shpërndan materialet, mban procesverbalin e mbledhjeve, harton, protokollon, njofton dhe arkivon vendimet e KKTKM-së, si dhe kryen çdo veprimtari tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjit 27/2018.

2. Sekretaria Teknike drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i IKTK-së, i cili është edhe sekretari i KKTKM-së. Në mungesë të tij detyrat ushtrohen nga një person tjetër i caktuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Detyrat e Sekretarisë Teknike janë si vijon:

- a) organizimi i mbledhjeve të KKTKM-së;
- b) kryerja e njoftimeve dhe shpërndarja e materialeve anëtarëve të KKTKM-së;
- c) mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve;



ç) hartimi i vendimit/relacionit, sipas vendimmarrjes së Këshillit Teknik dhe KKTKM-së;

d) njoftimin e vendimit kërkuësve;

dh) mbajtjen e regjistrit të vendimeve;

e) mbajtjen dhe administrimin e dosjeve të KKTKM-së;

ë) organizimin e shortit për caktimin e relatorit në Këshillin Teknik;

f) mban regjistrin publik të vlerave kulturore materiale;

g) mban regjistrin e subjekteve të licencuara në veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

gj) mban regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale;

h) mban regjistrin e subjekteve të licencuara në fushën e trashëgimisë arkeologjike;

i) mban regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore arkeologjike.

Neni 11

Regjistrat

1. Pranë Sekretarisë Teknike mbahen regjistrat si vijojnë:

a) Regjistri i vendimeve;

b) Regjistri publik i vlerave kulturore materiale;

c) Regjistri i subjekteve të licencuara në veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

ç) Regjistri kombëtar i lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale;

d) Regjistri i subjekteve të licencuara në fushën e trashëgimisë arkeologjike;

dh) Regjistri kombëtar i lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore arkeologjike.

2. Regjistri i vendimeve përmban të paktën të dhënat, për:

a) numrin e vendimit;

b) datën e vendimit;

c) objektin e vendimit;

ç) subjekti përfitues/aplikues;

d) datën e njoftimit.

3. Regjistrat mbahen në dy forma:

a) në formë manuale; dhe/ose

b) në formë elektronike.

Neni 12

Administrimi i dosjes nga Sekretaria Teknike

1. Sekretaria Teknike merr në shqyrtim dosjet e përcjella nga punonjësi i Sportelit Unik, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe verifikon nëse aplikimi dhe dokumentacioni i përcjellë është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, sipas llojit të aplikimit dhe verifikon veprimet e kryera nga nëpunësi i sportelit.

2. Nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj, sekretaria administron dosjen dhe, në përputhje me këtë rregullore, ua përcjell për shqyrtim të mëtejshëm sektorëve të përmbajtjes në IKTK dhe Këshillin Teknik.

3. Drejtori i Monumenteve të Kulturës dhe drejtori i Shërbimit Arkeologjik cakton një relator nga sektorët e përmbajtjes për prezantimin e çështjes para Këshillit Teknik dhe KKTKM-së. Relatori përgatit relacionin brenda 10 ditëve pune nga marrja në dorëzim e kërkesës dhe e dosjes përkatëse dhe ia përcjell Sekretarisë Teknike.

4. Relacioni dhe dosja përkatëse u përcillet për mendim të gjithë anëtarëve të Këshillit Teknik, nga Sekretaria Teknike.

Neni 13

Këshilli Teknik

1. Këshilli Teknik përbëhet nga 7 anëtarë të përzgjedhur nga radhët e anëtarëve të KKTKM-së, sipas VKM-së 208/2019 dhe nenit 6 të kësaj rregulloreje dhe kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i IKTK-së. Ky këshill vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura për miratim në KKTKM.

2. Anëtari i Këshillit Teknik ka të drejta dhe detyra si vijojnë:

a) të njihet me dosjen dhe çdo dokument tjetër që lidhet me çështjen për të cilën do të japë mendim;

b) të shprehë lirshëm mendimin e tij;

c) të kërkojë caktimin e ekspertëve të jashtëm kur vlerëson se çështja ka nevojë për ekspertizë më të thelluar;

ç) të marrë pjesë rregullisht në mbledhje;

d) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri;



dh) të ruajë konfidencialitetin për çështjet, dokumentet dhe faktet për të cilat ka marrë dijeni për shkak të detyrës;

e) të shmangë çdo situatë konflikti interesi;

ë) të arsyetojë mendimin kundër.

3. Veprimet lidhur me organizimin e mbledhjeve, njoftimet, shpërndarja e materialeve dhe vendimi kryhen nga Sekretaria Teknike sipas kësaj rregulloreje.

4. Në çdo mbledhje të Këshillit Teknik mbahet procesverbali përkatës nga Sekretaria Teknike, në të cilin reflektohen të gjitha diskutimet mbi çështjet e rendit të ditës dhe vendimarrja.

5. Procesverbali i paraqitet për miratim dhe nënshkrim të gjithë anëtarëve të Këshillit Teknik, në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse ose jo më vonë se zbardhja e vendimit të KKTKM-së. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari. Në rastin kur çështjet zgjasin më shumë se një mbledhje, procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit Teknik në përfundim të mbledhjes përkatëse.

6. Procesverbali i mbledhjes përfshin:

a) orën, datën, vendin e mbledhjes;

b) verifikimin e prezencës së pjesëmarrësve;

c) çështjet e diskutuara nga anëtarët e Këshillit Teknik;

ç) formën dhe rezultatin e votimeve;

d) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi;

dh) vendimarrjen e Këshillit Teknik;

e) mendimin e pakicës/mendimin kundër.

7. Këshilli Teknik miraton me vendim përfundimtar kërkesat që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtjeje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara paraprakisht nga KKTKM-ja. Në këtë rast, vendimet nënshkruhen nga Sekretari i KKTKM-së.

8. Relatori i çështjes, pasi mbledh gjithë informacionin nga Sekretaria Teknike, përgatit relacionin përfundimtar ose vendimin, sipas rastit, i cili përmban informacionin si vijon:

a) përshkrimin teknik, sipas kërkesës së paraqitur;

b) objektin e kërkesës;

c) zgjidhjen teknike të propozuar nga kërkuesi;

ç) vlerësimin teknik të Këshillit mbi përshkrimin teknik, kërkesën dhe zgjidhjen e propozuar;

d) vendimarrjen dhe votimin (sipas rastit);

dh) mendimin e arsyetuar të anëtarëve që votuan kundër.

9. Relacioni ose vendimi, sipas rastit, firmoset nga kryetari i Këshillit dhe i përcillet KKTKM-së nëpërmjet Sekretarisë Teknike së bashku me dosjen përkatëse.

10. Veprimet lidhur me organizimin e mbledhjeve, njoftimet, shpërndarja e materialeve dhe vendimeve kryhen nga Sekretaria Teknike, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 14

Caktimi dhe njoftimi i mbledhjeve

1. KKTKM-ja mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj.

2. Pas shqyrtimit të relacioneve të paraqitura nga Këshilli Teknik, kryetari i KKTKM-së vendos ditën dhe orën e thirrjes së mbledhjes dhe miraton rendin e ditës. Njoftimi me rendin e ditës dhe relacionin e Këshillit Teknik u përcillet gjithë anëtarëve nga Sekretaria Teknike, jo më vonë se 3 ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Anëtarët kanë të drejtë të propozojnë ndryshime ose shtesa në rendin e ditës përpara datës së mbledhjes.

3. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes, u komunikohet kërkuesve/aplikuesve nga sekretaria brenda, jo më vonë se 3 ditë, para datës së caktuar për mbledhjen. Së bashku me njoftimin sekretaria përcjell edhe rendin e ditës dhe, kur është rasti, kërkon dhe paraqitjen e dokumenteve të tjera lidhur me kërkesën.

4. Anëtarët dhe kërkuesit/aplikuesit marrin pjesë në mbledhjet e KKTKM-së në vendin, ditën dhe orën e përcaktuar në njoftim. Në rastin e pamundësisë për të marrë pjesë në kohën dhe vendin e caktuar, kanë detyrimin të njoftojnë paraprakisht kryetarin apo sekretarin e KKTKM-së mbi shkaqet e mungesës dhe mundësinë e shtyrjes së mbledhjes.

Neni 15

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Mbledhjet e KKTKM-së zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.



2. Fillimisht kryetari verifikon prezencën e anëtarëve. Në rastin e mungesës së anëtarëve, të kërkuarit/aplikuesit ose të ekspertëve, verifikon nëse ka shkaqe të justifikuara për mosparaqitjen dhe urdhëron mbajtjen e shënimit përkatës në procesverbalin e mbledhjes. Nëse është paraqitur kërkesë me shkaqet e justifikuara kryetari shqyrton kërkesën dhe nëse e gjen të bazuar mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes në një ditë dhe/ose orë tjetër.

3. Në rast se nga verifikimi rezulton se nuk formohet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje shtyn mbledhjen, por jo më vonë se 48 orë. Nëse kuorumi i kërkuar nuk formohet as në mbledhjen e radhës, kryetari shtyn mbledhjen edhe për një afat tjetër 48 orësh. Në rast të mosformimit sërish të kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje, KKTKM-ja vendos me të paktën gjysmën e anëtarëve.

4. Mbledhja e KKTKM-së mund të kërkohej edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve.

5. Në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, çdo anëtar i KKTKM-së, që ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore, ka detyrim të deklarojë konfliktin e interesit dhe të kërkojë mospërfshirjen e tij në shqyrtimin e çështjes përkatëse në rendin e ditës, përfshirë edhe procedurën e votimit. Anëtar i KKTKM-së nuk duhet të jetë autor apo bashkautor në projektet që i kalojnë për shqyrtim dhe miratim KKTKM-së. Në këtë rast, në kuptim të shkronjës “d”, të pikës 4, të nenit 3, ai konsiderohet në gjendje të konfliktit të vazhdueshëm të interesit dhe duhet të zbatojë kërkesat e nenit 38, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

6. KKTKM-ja mund të shqyrtojë dhe të votojë vetëm për ato çështje që janë përfshirë në rendin e ditës. Në mbledhje mund të shqyrtohen çështje të tjera vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët të cilët miratojnë përfshirjen e çështjes në rendin e ditës.

Neni 16

Vendimmarrja

1. Votimi në KKTKM është i hapur dhe të gjithë anëtarët duhet të votojnë. Abstenimi nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur anëtar i ka pengesë ligjore ose konflikt interesi në çështjen për të cilën do të merret vendim. Anëtarët që votojnë kundër duhet të argumentojnë me shkrim mendimin e tyre.

2. Kryetari i KKTKM-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Vendimet e KKTKM-së nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretari i KKTKM-së. ndërsa projektet firmosen vetëm nga Sekretari i KKTKM-së. Format i vendimeve paraqitet si aneks bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

4. Vendimi i KKTKM-së zbardhet nga Sekretaria Teknike në bazë të procesverbalit, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

5. Një projekt quhet i miratuar, kur me shumicë votash vendoset pranimi i tij pa pasur nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime. Në rastin kur KKTKM-ja vendos se një projekt ka nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime, projekti nuk konsiderohet i miratuar. Në këtë rast procedohet me shtyrje të vendimmarrjes dhe plotësimin me propozimet dhe/ose kërkesat e lëna nga KKTKM-ja. Projekti rishqyrtohet në KKTKM pas plotësimit të tij nga subjekti aplikues. Procedura e rishqyrtimit, për plotësimet apo ndryshimet do të jetë e njëjtë.

6. Vendimi i njoftohet subjektit të interesuar jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes së tij, sipas rregullave të njoftimit të akteve administrative në bazë të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 17

Shqyrtimi i çështjeve me procedurë të përsheptuar

Në raste të jashtëzakonshme të fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura apo për çështje të një rëndësie të veçantë të interesit publik, kur rrezikohet dëmtimi i pasurive kulturore, KKTKM-ja merr vendim me procedurë të përsheptuar brenda 15 ditëve. Në këtë rast, vendimi firmoset nga kryetari dhe të gjithë anëtarët.



Neni 18

Shqyrtimi i kërkesave për licencë dhe leje

Shqyrtimi dhe miratimi kërkesave për licencë dhe leje nga KKTKM-ja bëhet përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse të dala në zbatim të ligjit 27/2018. Procedura për shqyrtimin e tyre bëhet sipas hapave të përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 19

Ekspertët e jashtëm

Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj vendimmarrëse KKTKM-ja mund të thërrasë, rast pas rasti, ekspertë të jashtëm, kur vlerëson që është e nevojshme, për shkak të natyrës së veçantë apo teknike të çështjes ose të kërkojë dokumente shtesë nga kërkuessit. Ekspertët japin opinionin e tyre

verbalisht ose me shkrim, sipas kërkesave dhe/ose detyrave të përcaktuara nga KKTKM-ja dhe nuk kanë të drejtë vote. Nëse për paraqitjen e ekspertëve ose depozitimin e dokumente të tjera është e nevojshme caktimi i një seance tjetër, KKTKM-ja cakton një datë tjetër për paraqitjen e ekspertit, dëgjimin e kërkuessve ose paraqitjen e dokumenteve të tjera shtesë.

Neni 20

Dispozitat e fundit

1. Çdo urdhër, udhëzim apo rregullore që është në kundërshtim me këtë rregullore shfuqizohet.

2. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të KKTKM-së dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____._____

VENDIM

Nr. ____, datë _____._____._____

Në mbështetje të nenit ____ të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe vendimit nr. 208, datë 10.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit të _____, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës _____._____._____,

VENDOSI:

1. Miratimin e “.....”;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (sipas rastit);
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147 (sipas rastit);
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2 (sipas rastit);
5. Subjekti “_____” duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “_____” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt (sipas rastit);
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR**SEKRETAR**

Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, nr. 76, Kinostudio, Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr.	Prot.
-----	-------

Tiranë, më . . .

VENDIM (Qarkullues)

Nr. _____, datë _____. _____

Në mbështetje të nenit ____ të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pasi u njoha me kërkesën për _____, vendos:

- Miratimin e “ ”

Jam dakord me miratimin e këtij propozimi:

[illegible]

1. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËRKESË**

Shtetasi Safet Mustafaraj, i datëlindjes 13.6.1966, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Zenel Mustafaraj, i datëlindjes 1.6.1964.

KËRKUES
Safet Mustafaraj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë